



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2581, datë 22.06.2015

Për

**“Dhënien e Autorizimit Individual subjektit “Posta Shqiptare” Sh.a. për ofrimin e shërbimit universal postar”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.06.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Dhënia e Autorizimit Individual subjektit “Posta Shqiptare” Sh.a për ofrimin e shërbimit universal postar.**

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;
- Dokumenti: “Autorizimi Individual i “Posta Shqiptare” Sh.a për ofrimin e shërbimit universal postar”.

## BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 7, pika 1 e nenit 9 dhe pika 3 e nenit 64 të Ligjit Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 46/2015**),
2. Pika 3 e nenit 114 të Ligjit Nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
3. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar (**ligji nr. 8485**);
4. Rregullore e brendshme e AKEP, miratuar me Vendim nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

## V Ë R E N:

1. Ligji Nr. 46/2015, 2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015. Ky ligj zëvendëson Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në bazë të nenit 67 të tij, Ligji 46/2015 hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji 46/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.85, datë 26.05.2015.
2. Pika 3 e nenit 64 të ligjit 46/2015 citon: *Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, AKEP-i i jep shoqërisë “Posta Shqiptare”, sh.a. autorizimin individual, si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar, me afat pesëvjeçar. AKEP-i kryen procesin e rishikimit të parë për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, në përfundim të këtij afati.*
3. Bazuar në përcaktimet e ligjore të mësipërme, AKEP me Urdhërin nr. 1475, datë 01.06.2015, ka ngritur një Grup Pune për përgatitjen e Autorizimit Individual për Postën Shqiptare si ofrues i vetëm i shërbimit Universal Postar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Në përgjigje të shkresës dërguar nga AKEP me nr. 1135, datë 1.06.2015 “Kërkesë për informacion për pajisjen me Autorizim Individual”, Posta Shqiptare sh.a. me shkresën nr. 2091/1, datë 10.06.2015, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar nga AKEP, dhe ky dokumentacion është në përputhje me kërkesën e AKEP.
5. Dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin Nr.1475, datë 1.06.2015, përbëhet nga:
  - a) Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
  - b) Dokumenti “Autorizimi Individual i “Posta Shqiptare” Sh.a për ofrimin e shërbimit universal postar;

- c) Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD dhe dokumentin e Autorizimit Individual;
6. Projekti i “Autorizimit Individual për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar” i përgatitur nga grupi i punës u konsultua edhe me një grup ekspertësh të “Postës Shqiptare sh.a” në një takim dypalësh, të cilët dhanë dhe propozime për draftin e diskutuar.
  7. Bazuar në Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, i ndryshuar, shërbimi universal postar është ofruar nga Posta Shqiptare në bazë të një Marrëveshje të lidhur me Ministrin. Ndërkohë sipas ligjit 46/2015 shërbimi universal postar ofrohet në bazë të një autorizimi individual të lëshuar nga AKEP. Të drejtat dhe detyrimet e shprehura në Marrëveshjen e Posta Shqiptare sh.a me Ministrin Nr.1713, datë 26.05.2011 (Referenca e letrës së Këshillit të Ministrave), “Për ngarkimin e përbushjes së detyrimeve të shërbimit bazë postar në Republikën e Shqipërisë”, që kanë lidhje me shërbimin universal postar (sidomos të treguesve të cilësisë) dhe që janë në përputhje me Ligjin 46/2015 janë përdorur nga AKEP me qëllim transpozimin e tyre në Autorizimin Individual të Postës Shqiptare. Nga të dhënat e depozituara nga Posta Shqiptare, rezulton se Posta Shqiptare është në përbushje të detyrimeve në lidhje me shërbimin bazë postar (shërbimi universal postar) të marrëveshjes së cituar.
  8. AKEP në përgatitjen e autorizimit individual të Posta Shqiptare ka përdorur si referencë:
    - Ligji 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”;
    - Direktivat “Për shërbimin Universal Postar”;
    - Marrëveshjen në fuqi të subjektit “Posta Shqiptare” me Ministrin nr. 1713, datë 26.05.2011 “Për ngarkimin e përbushjes së detyrimeve të shërbimit bazë postar në Republikën e Shqipërisë”;
    - Eksperiencën e vendeve rregullatore të rajonit, kryesisht të Kroacisë, Italisë, Sllovenisë, Maltës, Serbisë dhe Danimarkës, etj;
    - Dokumentacionin e dërguar nga Posta Shqiptare për t’u pajisur me Autorizim Individual me nr. 2091/1, datë 10.06.2015;
    - Eksperinca e AKEP në veprimtarine rregullatore.
  9. Ligji 46/2015 përmban një sërë përcaktimesh për përgatitjen nga AKEP të disa dokumenteve nënligjore që kanë lidhje me shërbimin universal. Këto dokumente rregullatore do të duhet të përgatiten brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit 46/2015. Plotësimi i kuadrit rregullator për shërbimin universal do të kërkojë edhe amendime të mundshme të Autorizimit Individual të miratuar me këtë Vendim të AKEP.
  10. Dokumenti “Autorizimi Individual i “Posta Shqiptare” Sh.a për ofrimin e shërbimit universal postar”, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm në tregun e shërbimit postar, i cili i vendos të drejta dhe detyrime “Posta Shqiptare” sh.a për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësin[ e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

## V E N D O S:

1. Pajisjen e subjektit “Posta Shqiptare” sh.a. me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë sipas dokumnetit bashkangjitur këtij vendimi.
2. “Posta Shqiptare” sh.a. ka detyrim të ofrojë shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të Autorizimit Individual të miratuar me këtë vendim si dhe sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të sektorit postar.
3. “Posta Shqiptare” sh.a të paguajë 10.000 lekë për pajisjen me këtë autorizim individual.
4. Ky Vendim dhe Dokumenti “Autorizimi Individual i “Posta Shqiptare” Sh.a per ofrimin e shërbimit universal postar”, të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

## ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në bazë të nenit 64, pika 3 e Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në RSH”,

AKEP pajis me

## **AUTORIZIM INDIVIDUAL**

**Për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar  
në Territorin e Republikës së Shqipërisë**

**PERSONIN JURIDIK  
“POSTA SHQIPTARE SH.A.”**

**I VLEFSHËM DERI MË: 6.07.2020**

Miratur me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2581, datë 22.06.2015.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

## **TERMAT, DETYRIMET DHE KUSHTET PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR**

### **1. Objekti i Autorizimit Individual**

Në përputhje me ligjin nr. 46, datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (ligji 46/2015), neni 64, pika 3, shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a (në vijim Posta Shqiptare) regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me numër identifikimi NIPT J61924007N, me seli në adresën: Rruga "Rreshit Collaku", Nr. 4, Tiranë, pajiset me këtë Autorizim Individual si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me afat vlefshmërie 5 (pesë) vjet nga data e dhënies së këtij autorizimi.

### **2. Terma dhe Shkurtime**

Perveç sa parashikohet në nenin 3 të Ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në RSH” termat dhe shkurtime të mëposhtme do të kenë këto kuptime:

- 2.1. **“Kod postar”** është një mjet identifikues dhe element themelor e një adrese postare, dhe përmban informacionin e nevojshëm për vijimin e objektit postar deri në dorëzimin e tij. Ai është i përbërë nga 4 karaktere numerike.
- 2.2. **“Shërbime të rezervuara”** janë shërbimet e kryera ekskluzivisht nga operatori publik i postave, për të përmbushur detyrimin e shërbimit universal postar, për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.788, datë 26.11.2004, i ndryshuar me VKM Nr.711, datë 21.08.2013.
- 2.3. **“Zyra postare”** është një ambient biznesi i përdorur nga “Posta Shqiptare” Sha. apo nënkontraktorët e tij për të ofruar shërbimet postare.
- 2.4. **“CEN”**: Komiteti Evropian i Standardeve
- 2.5. **“DPS”**: Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) e Republikës së Shqipërisë

### **3. Fusha Shërbimit Universal Postar dhe Kërkesa të Ofrimit të Tij**

- 3.1 Posta Shqiptare ka detyrimin e ofrimit të shërbimit universal postar çdo përdoruesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, duke përfshirë shërbimet postare brenda vendit dhe ndërkombëtare për:
  - a. pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e objekteve postare që peshojnë deri në 2 kg;
  - b. pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e pakove postare që peshojnë deri në 10 kg;
  - c. shërbimet për objektet postare të regjistruara dhe objektet postare të siguruara.

- 3.2 Pavarësisht nga kufiri i peshës për pakot postare, i përcaktuar në pikën më sipër, Posta Shqiptare duhet të sigurojë që objektet postare, të pranuar nga një vend anëtar i BE-së dhe që peshojnë deri në 20 kg, të shpërndahen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Përmasat minimale dhe maksimale për objektet postare, që janë pjesë e shërbimit universal duhet të jenë në përputhje me aktet e miratuara nga UPU-ja.
- 3.4 Posta Shqiptare ka detyrimin të sigurojë ofrimin e shërbimit universal për çdo përdorues, të paktën në 5 ditë në javë, duke ofruar, me përjashtim të rrethanave ose kushteve gjeografike të cilat konsiderohen të jashtëzakonshme:
- pranimin e objektit postar;
  - shpërndarjen e objektit postar në banesë ose në ambientet e çdo personi fizik apo juridik.
- 3.5 Në ofrimin e shërbimit universal postar Posta Shqiptare duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:
- të ofrojë shërbimin universal postar me çmime të përballueshme në të gjitha pikat e aksesit në territorin e vendit;
  - të ofrojë shërbimin universal postar në përputhje me kriteret thelbësore;
  - t'u ofrojë shërbim të njëjtë përdoruesve në kushte të krahasueshme;
  - të ofrojë shërbimin/et pa asnjë formë diskriminimi;
  - të sigurojë që shërbimi të mos ndërpritet ose bllokohet, me përjashtim të rasteve të një force madhore;
  - të sigurojë që shërbimi të zhvillohet në përputhje me ambientin teknik, ekonomik e social dhe nevojat e përdoruesve.
- 3.5 Posta Shqiptare harton termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve postare që janë pjesë e shërbimit universal postar. Termat dhe kushtet e përgjithshme duhet të përmbajnë informacionin e specifikuar në pikën 1 të nenit 32 të ligjit 46/2015, si dhe standardet dhe cilësinë e shërbimit, rregullat për postimin nga përdoruesi të objekteve postare dhe shpërndarjen e tyre nga Posta Shqiptare.
- 3.6 Termat dhe kushtet e përgjithshme të hartuara nga Posta Shqiptare, i dërgohen AKEP-it për shqyrtim dhe miratim 30 ditë para aplikimit të tyre dhe AKEP ka të drejtë të kërkojë apo imponojë ndryshimin e tyre nëse ato nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 46/2015 dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
- 3.7 Termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimeve postare të Postës Shqiptare që janë pjesë e shërbimit universal postar publikohen në faqen zyrtare të internetit të Posta Shqiptare. Posta Shqiptare duhet të mbajë kopje fizike në format të printuar dhe lehtësisht të lexueshëm të termave dhe kushteve të përgjithshme në zyrat postare të saj për t'i bërë të disponueshme për përdoruesin ose për t'i dërguar në adresën e përdoruesit postar nëse kjo kërkohet prej tij.
- 3.8 Posta Shqiptare publikon në faqen e internetit informacionet që lidhen me shërbimin universal postar sipas kërkesave të ligjit 46/2015, akteve rregullatore duke përfshirë dhe informacion në lidhje me:
- zyrat postare dhe oraret e tyre;
  - tarifat dhe çmimet;
  - procedurat e reklamimit dhe të rimbursimit;
  - modalitetet e aksesit në shërbime;
  - standardet e cilësisë;
  - aksesi për gjurmimin e objekteve postare të brendshme dhe ndërkombëtare;

#### **4. Rrjeti postar për sigurimin e shërbimit universal**

- 4.1. Pjesët përbërëse të rrjetit postar të Postës Shqiptare janë pikat e aksesit, qendrat e shpërndarjes dhe pjesët e tjera që sigurojnë ofrimin e shërbimit universal postar.
- 4.2. Pikat e aksesit të rrjetit, të cilat mundësojnë për përdoruesit, ofrimin e shërbimit universal postar do të jenë:

- a. zyrat postare;
  - b. qendrat e shpërndarjes;
  - c. kutitë postare;
  - d. pajisjet e tjera për pranimin e objekteve postare.
- 4.3. Zyra postare është një ambient biznesi i përdorur nga Posta Shqiptare apo nënkontraktori i tij që mundësojnë ofrimin e shërbimeve postare si dërgimi dhe marrja e letrave dhe pakove, përfshirë objektet e regjistruara dhe të siguruara si dhe blerje të pullave postare. Zyrat postare identifikohet nga emri/numri dhe kodi postar dhe mund të kategorizohen si më poshtë:
- a. Zyrë postare universale: *që ofrojnë shërbim të plotë universal të paktën 5 ditë në javë*
  - b. Zyrë postare e lëvizshme sezonale: *zyra të përkohëshme gjatë kërkesës më të madhe si sezon turistik.*
  - c. Zyrë agjenti postar : *zyrë e një agjenti postar të Postës Shqiptare në të cilin kjo e fundit ka kontratë për ofrimin e shërbimit universal.*
- 4.4. Oraret e shërbimit të një zyre postare për përdorimin e shërbimeve nga përdoruesit postarë do të përcaktohen nga Posta Shqiptare në bazë të kriterëve të mëposhtme:
- a. nevojat e përdoruesve të shërbimit universal postar;
  - b. treguesit e cilësisë për ofrimin e shërbimit universal postar;
  - c. rrethana të veçanta.
- 4.5. Për ndryshimin e përhershëm të orarit të shërbimit të zyrave postare, Posta Shqiptare duhet të njoftojë AKEP-in me shkrim 7 (shtatë) ditë para këtij ndryshimi. Për përdoruesit njoftimi bëhet me një lajmërim të afishuar në derën e zyrës postare dhe në faqen web.
- 4.6. AKEP ka të drejtë të përcaktojë specifikime dhe rregulla shtesë për përcaktimin e orarit të ofrimit të shërbimeve në zyrat postare të Postës Shqiptare.
- 4.7. Nëse Posta Shqiptare dëshiron të mbyllë apo zhvendosë një zyrë postare universale ajo duhet të konsultohet paraprakisht me organet e pushtetit vendor përkatës dhe palë të tjera të interesuara.
- 4.8. Posta Shqiptare duhet të njoftojë AKEP-in mbi vendimin për mbylljen apo zhvendosjen e zyrës postare të paktën 30 ditë para realizimit të mbylljes apo zhvendosjes. Njoftimi do të shoqërohet me gjithë dokumentacionin argumentues për veprimin e kryer.
- 4.9. Posta Shqiptare duhet të depozitojë në AKEP brenda muajit Janar të çdo viti gjendjen aktuale dhe zhvillimet e pritshme në rrjetin e zyrave postare dhe pikave të aksesit për sigurimin e shërbimit universal. Në këtë informacion përfshihen dhe parashikimet për mbylljen apo zhvendosjen e zyrave postare për vitin në vijim.

## **5. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar**

- 5.1. Posta Shqiptare detyrohet të organizojë rrjetin e zyrave postare në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyre që:
- a. një zyrë postare të mbulojë me shërbim mesatarisht një sipërfaqe jo më të madhe se 56 km<sup>2</sup>, dhe
  - b. një zyrë postare t'u ofroje shërbim mesatarisht jo më shumë se 6500 banorëve;
- 5.2. Dendësia e pikave të aksesit për shërbimin universal miratohet nga Ministri pas konsultimit me AKEP sipas përcaktimeve të Ligjit 46/2015.



5.3. Standardet e cilësisë për shërbimin universal postar brenda vendit të ofruar nga Posta Shqiptare do të jenë:

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje sipas afatit)
<b>Brenda për brenda qytetit</b>	<b>D + 1</b>	<b>95%</b>
	<b>D + 2</b>	<b>5%</b>
<b>Ndërmjet qyteteve</b>	<b>D + 1</b>	<b>85%</b>
	<b>D + 2</b>	<b>15%</b>
<b>Në fshatra</b>	<b>D + 2</b>	<b>60%</b>
	<b>D + 3</b>	<b>20%</b>
	<b>D + 4</b>	<b>20%</b>

5.4. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar ndërkombëtar të ofruar nga Posta Shqiptare do të jenë:

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje kumulative)
<b>Vendet e BE (Poste Europe)</b>	<b>D + 3</b>	<b>85%</b>
	<b>D + 5</b>	<b>97%</b>
<b>Vendet e Tjera (UPU)</b>	<b>D + 5</b>	<b>85%</b>

*Shënime për tabelat në pikat 5.3 dhe 5.4:*

- *Objektivat e mësipërm të cilësisë janë për objektet postare me kohë më të shpejtë shpërndarjeje.*
- *D: data e depozitimit (pranimi) të objektit postar në Postën Shqiptare.*
- *n: numri i ditëve të punës (përfshihen ditët e pushimit dhe festat zyrtare) që duhen për shpërndarjen e objektit nga data e pranimi deri në datën e shpërndarjes tek i adresuari.*

5.5. Ofrimi i shërbimeve postare universale duhet të realizohet në përputhje me standardet europiane dhe ato boterore për shërbimet postare universale, të përcaktuara nga UPU-ja.

5.6. AKEP ka të drejtë të monitorojë apo auditojë treguesit e cilësisë së shërbimit universal të ofruar nga Posta Shqiptare sipas përcaktimeve të Ligjit 46/2015.

5.7. AKEP-i miraton me rregullore treguesit e detajuar të cilësisë së ofrimit të shërbimit universal postar dhe kërkesa të detajuara për ofrimin e shërbimit universal postar.

5.8. AKEP-i kryen mbikëqyrjen e pavarur të sigurimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit universal postar nga Posta Shqiptare, të paktën një herë në vit. Rezultatet e mbikëqyrjes publikohen në faqen e AKEP-it.

5.9. Posta Shqiptare ka detyrimin e plotësimit të standardeve të mëposhtme të shërbimit postar të CEN të transpozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) e Shqipërisë:

- **S SH EN 13850:2012:** Shërbimi postar – Cilësia e shërbimit – Matja e kohës së tranzitit të shërbimeve nga fillimi në fund (end-to-end) për pjesë të veçanta të dërgimit prioritar me postë dhe dërgimi me postë i klasit të parë

- **S SH EN 14508:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për një pjesë jo prioritare të dërgimit me postë dhe dërgimi me postë i klasit të dytë
- **S SH EN 14534:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për dërgesat me postë me grumbuj të pa ambalazhuar.

## **6. Tarifat dhe kostot për ofrimin e shërbimit universal postar**

- 6.1. Tarifat për çdo shërbim që bën pjesë në shërbimin universal postar duhet të përmbushin parimet e mëposhtme:
  - a. të jenë të përballueshme dhe të tilla që të gjithë përdoruesit, pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike, të kenë akses në shërbimet e ofruara;
  - b. të jenë të orientuara drejt kostos dhe të sigurojnë nxitje për ofrimin efikas të shërbimit universal postar;
  - c. të jenë të njëjta për shërbime të njëjta në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - d. të jenë transparente dhe jodiskriminuese, të mos dëmtojnë konkurrencën.
- 6.2. AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave të shërbimit universal të ofruar nga Posta Shqiptare sipas përcaktimeve të Ligjit 46/2015.
- 6.3. Tarifat për shpërndarjen e objekteve postare që vijnë nga jashtë vendit dhe që janë pjesë e shërbimit universal përcaktohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumë palëshe midis Postës Shqiptare dhe ofruesve përkatës të shërbimeve postare jashtë vendit ose në bazë të detyrimeve terminale të përcaktuara në përputhje me rregullat e miratuara nga aktet e UPU-së.
- 6.4. Posta Shqiptare duhet të mbajë llogari të ndara për të dalluar, në mënyrë të qartë, shërbimet dhe produktet që janë pjesë e shërbimit universal postar dhe ato që nuk janë pjesë e këtij shërbimi, me qëllim llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar dhe kostove neto të tij.
- 6.5. Rregullat e detajuara për ndarjen e llogarive dhe metodat dhe mënyrat e përcaktimit dhe evidentimit të kostove të shërbimit universal si dhe procedurat dhe afatet e dorëzimit të tyre në AKEP, përcaktohen nga AKEP me rregullore.
- 6.6. Nëse Posta Shqiptare pretendon të drejtën e kompensimit për sigurimin e shërbimit universal postar, duhet të paraqesë në AKEP pretendimin, së bashku me argumentimin dhe informacionin për kostot reale, të dhënat e përdorura për llogaritjen e kostove neto aktuale të shërbimit universal postar dhe pasqyrat financiare nga sistemi i llogarive të ndara dhe sipas rregullave të përcaktuara nga AKEP në rregulloren e cituar më sipër.

## **7. Të drejta të tjera për Postën Shqiptare**

### **Shërbimet e rezervuara**

- 7.1. Si kompensim i përkohshëm për të përmbushur detyrimin e shërbimit universal postar Posta Shqiptare ka të drejtën ekskluzive për ofrimin e shërbimeve në zonën e rezervuar për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, me çmim dhe kufi peshe, siç përcaktohet në VKM Nr.788, datë 26.11.2004, i ndryshuar me VKM Nr.711, datë 21.08.2013.
- 7.2. Bën përjashtim nga zona e rezervuar korrespondenca vetjake apo e biznesit, e cila shpërndahet vetë, pa pagesë dhe pa ndërmjetësinë e të tretëve.
- 7.3. Posta Shqiptare vazhdon të ushtrojë të drejtën ekskluzive për ofrimin e shërbimeve postare të rezervuara deri më 31.12.2016.

## **Pullat Postare**

7.4. Posta Shqiptare ka të drejtën ekskluzive për prodhimin, emetimin, vënien në qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi të pullave postare Shqiptare sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit 46/2015.

## **Kodi Postar**

7.5. Posta Shqiptare mban sistemin e kodit postar që përdoret në ofrimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë dhe që synon të garantojë vijimin e saktë të objektit postar në adresën përkatëse.

7.6. Posta Shqiptare publikon në faqen e vet të internetit sistemin e kodit postar në Republikën e Shqipërisë, përfshirë ndryshimet e mundshme.

7.7. Kodi postar miratohet nga autoriteti përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

## **8. Detyrime të tjera për Postën Shqiptare**

8.1. Posta Shqiptare duhet të përmbushë detyrimet e vendosura nga UPU nëpërmjet akteve me natyrë detyruese dhe sipas marrëveshjeve të tjera të nënshkruara nga Shteti Shqiptar nën kujdesin e UPU si dhe marrëveshjeve të tjera me natyrë ndërqeveritare si pjesëmarrës në organizata ndërkombëtare.

8.2. Posta Shqiptare duhet të zbatojë standardet detyruese për shërbimet postare të miratuara dhe transpozuar nga BE ose UPU.

8.3. Posta Shqiptare harton një plan veprimi për sigurimin e ofrimit të shërbimit postar në rastin e situatave të jashtëzakonshme, të cilin ia paraqet ministrit dhe AKEP-it. Me situatë të jashtëzakonshme kuptohet dëmtimet e rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendjen e emergjencës ose gjendjen e luftës.

8.4. Të dhënat personale të përdoruesve dhe të shërbimit universal postar, ruhen dhe administrohen nga ofruesi i shërbimit universal postar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8.5. Posta Shqiptare duhet të kryejë pagesën për mbikëqyrjen e tregut postar në përputhje me nenin 27 të Ligjit 46/2015 dhe aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij.

8.6. AKEP për mbrojtjen e interesit të përdoruesit dhe/ose për të nxitur konkurrencën efektive, bazuar në rrethanat specifike të vendit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, kur është e nevojshme, ka të drejtë të vendosë detyrime për Postën Shqiptare për të dhënë akses në rrjetin e tij postar ofruesve të tjerë të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të nenit 35 të Ligjit 46/2015.

8.7. Mosmarrëveshjet ndërmjet Postës Shqiptare dhe ofruesve të tjerë të shërbimit postar në Republikën e Shqipërisë zgjidhen nga AKEP sipas përcaktimeve të nenit 56 të Ligjit 46/2015.

8.8. Mosmarrëveshjet ndërmjet Postës Shqiptare si ofruesi i shërbimit universal postar dhe përdoruesve të këtij shërbimi që lidhen me zbatimin e ligjit dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij, zgjidhen nga AKEP-i sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit 46/2015.

8.9. Të gjitha aktet ligjore kombëtare dhe ato ndërkombëtare, aktet nënligjore dhe rregullatore, vendimet e Autoritetit që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shërbimit universal postar, janë apo bëhen pjesë integrale e Autorizimit Individual dhe të detyrueshme për t'u zbatuar nga Posta Shqiptare sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin 46/2015.

## **9. Hyrja në fuqi, afati i vlefshmërisë, ndryshimet, mbikqyrja, etj**

9.1. Ky Autorizim Individual hyn në fuqi në datën e përcaktuar në vendimin e AKEP për miratimin e tij. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual është 5 (pesë) vjet nga data e hyrjes në fuqi.

- 9.2. Termat dhe kushtet e këtij Autorizimi Individual mund të ndryshohen apo plotësohen në përputhje me aktet e miratuara nga AKEP që kanë lidhje me shërbimin universal postar si dhe akteve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë lidhje me objektin e këtij autorizimi individual.
- 9.3. Transferimi i këtij Autorizimi Individual nga Posta Shqiptare në favor të nje pesoni fizik apo juridik tjetër nuk është i lejueshëm.
- 9.4. Ndryshimi, revokimi dhe përfundimi i vlefshmërisë së Autorizimit Individual kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 23-26, të ligjit nr.46/2015.
- 9.5. Posta Shqiptare duhet të sigurojë në kohë çdo informacion që AKEP mund të kërkojë në ushtrimin e funksioneve të tij. Informacioni mund të jepet me kërkesë të AKEP ose sipas kërkesave të ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore
- 9.6. Zbatimi i kushteve të këtij autorizimi individual dhe akteve të tjera që kanë lidhje me shërbimin universal postar të ofruar nga Posta Shqiptare monitorohet dhe mbikëqyret nga AKEP.
- 9.7. Nëse AKEP evidenton se Posta Shqiptare nuk ushtron aktivitetin e shërbimit universal postar në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Autorizim, AKEP mund të ndërmarrë veprimet dhe masat e nevojshme sipas dispozitave të parashikuara në ligjin 46/2015.